



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 16 janar 2020, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e rregullores “Për dhënien e licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale”. **(Vendimi nr. 1, datë 16.01.2020)**
2. Miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”. **(Vendimi nr. 2, datë 16.01.2020)**
3. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Tv Kombi” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “Tv Kombi”. **(Vendimi nr. 3, datë 16.01.2020)**
4. “Dhënien e autorizimit shoqërisë “DIGICOM” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT) si dhe konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Digicom” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV). **(Vendimi nr. 4, datë 16.01.2020)**
5. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Tv Kabllor Vlora Cable”, dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 21, datë 17.12.2019, në masën 1,000,000 lekë të vendosur ndaj subjektit “Tv me kabëll Vlora Cable”. **(Vendimi nr. 5, datë 16.01.2020)**

AMA në këtë mbledhje mori në shqyrtim çështjen e vlefshmërisë së licencave /autorizimeve të subjekteve debitorë ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit dhe ra dakord të njoftojë subjektet për shlyerjen e detyrimeve financiare dhe vijimin e procedimit administrativ në mbledhjen e radhës.

Po ashtu, AMA mori në shqyrtim aplikimet e subjekteve audio “Radio Emanuel” dhe “Radio 7” për rinovimin e licencës dhe ndryshimet në strukturën e pronësisë dhe ra dakord që subjekteve të mësipërme t’u kërkohet informacion nëse kanë interes të jenë subjekte audio me përmbajtje programore gjeneraliste apo me përmbajtje fetare.

Tiranë, 16 janar 2020

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

AMA në këtë mbledhje mori në shqyrtim çështjen e vlefshmërisë së licencave /autorizimeve të subjekteve debitorë ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit dhe ra dakord të njoftojë subjektet për shlyerjen e detyrimeve financiare dhe vijimin e shqyrtimit në mbledhjen e radhës.

Po ashtu, AMA mori në shqyrtim aplikimet e subjekteve audio “Radio Emanuel” dhe “Radio 7” për rinovimin e licencës dhe shqyrtimin e ndryshimeve në strukturën e pronësise dhe ra dakord që subjekteve të mësipërme t’u kërkohet nëse kanë interes të jenë subjekte audio me përmbajtje programore gjeneraliste apo me përmbajtje fetare.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE